



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E PROVIMEVE

Nr. .... Prot.  
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2015

**Njoftim i rëndësishëm**

*(Për marrjen e masave organizative për plotësimin online të formularit A1&A1Z sipas kalendarit bashkëngjitur)*

*Të nderuar kolegë Drejtorë,*

Ju njoftojmë se Portali i Maturës Shtetërore për aplikimin e Formularit A1 aktivizohet duke filluar nga dita e martë dt.10.03.2015, çdo ditë nga ora 8 – 16.30. Para dhe pas kësaj ore për çdo arsye nuk ka aplikim. Sistemi do të jetë i hapur ditët e shtuna dhe të diela për Dar/Za-të që e kanë datën e aplikimit sipas kalendarit të miratuar nga MAS. Të gjithë maurantët që nuk kanë aplikuar më parë në portalin qeveritar, duhet fillimisht të hyjnë në këtë sistem për t'u autentifikuar. Kjo masë është e detyrueshme për arsyen që të dhënat e lidhura me gjeneralitetet e tyre duhet të jenë plotësisht të sakta. Kjo presupozon që në çdo laborator ku do të bëhen aplikimet dy ose tre kompjuterë të jenë në dispozicion për lidhjen e me portalin qeveritar. Pas aplikimit në këtë portal, maurantët futen në kompjuterët e tjerë të sallës ku fillimisht është loguar mbikëqyrësi me username (ID) dhe password (fjalëkalim). Theksojmë se logimi i mbikëqyrësit të shkollës së mesme bëhet në mënyrë të detyrueshme pa praninë e asnjë maturanti dhe për më tepër asnjë personi tjetër në sallë. Identifikimi i mbikëqyrësit bëhet në portalin e Maturës Shtetërore, [matura.akp.gov.al](http://matura.akp.gov.al) (ndiqni udhëzimin përkatës). Nëse ka raste maturantësh që për një arsye ose tjetër nuk mundën të logohen në portalin qeveritar, ata do të bëjnë aplikimin drejtpërdrejt në portalin e Maturës Shtetërore. Përveç mbikëqyrësit në mjediset e shkollës duhet të jenë prezent mësuesi i informatikës (për korrigjimin e ndonjë problemi teknik) dhe mësuesit kujdestar të klasave maturë. Për të rritur sigurinë dhe saktësinë e futjes së informacionit, mësuesi kujdestar do të monitorojë një ose dy kompjuterë afër njëri-tjetrit për aplikimin e maturantëve të klasës së tij/saj kujdestare. Për ta bërë më të qartë këtë skemë organizimi po japim një shembull ilustrues:

Supozojmë se kemi një sallë me 16 kompjuterë në gjendje të mirë pune dhe të lidhur me internetin dhe me një printer të konfiguruar si printer rrjeti me furnizim të mjaftueshëm boje printeri (toner) dhe letër format A4. Dy kompjuterë të sallës aksesohen në portalin qeveritar, në 14 kompjuterat e tjerë aksesohemi në portalin e Maturës Shtetërore, [matura.akp.gov.al](http://matura.akp.gov.al) pasi mbikëqyrësi pa prezencën e askujt në sallë është loguar duke u identifikuar me username (ID) dhe password (fjalëkalim). Pas këtij hapi në sallë futen 7 mësues kujdestar të cilët monitorojnë aplikimin online të maturantëve të klasave të tyre përkatëse në dy kompjuterë afër njëri-tjetrit.

Ky shembull është i lidhur me një rast konkret të një shkolle të mesme me shumë matura paralele dhe do të përshtatet në varësi të madhësisë së laboratorit dhe shkollës. Misioni i mësuesit kujdestar është monitorimi i saktësisë së plotësimit të Formularit A1 si dhe plotësimi i bllokut të të dhënave që duhet të hidhen në sistem nën përgjegjësinë personale të tij, si indeksi i profilit të shkollës, emërtimi i profilit, lloji i gjuhës së huaj që do të jepet si provim i detyrueshëm D3, si dhe emërtimin e lëndëve të detyruara dhe me zgjedhje si dhe notat e mbartura në këto provime të dhëna më parë për aplikuesit me formularin A1Z. Gjithashtu mësuesi kujdestar firmos formularin A1 ose A1Z pas printimit të tij.

Për t'ju ardhur në ndihmë DAR/ZA-ve për zhvillimin e suksesshëm të aplikimit të Formularit A1 dhe A1Z, pranë AKP-së është ngritur një grupe pune specialistësh (Help Desk) të cilët do të jenë të gatshëm të përgjigjen për të gjitha problematikat e mundshme që do t'u shfaqen gjatë aplikimit të formularit A1 dhe A1Z. Kontakti me këtë grup pune nga ana juaj mund të bëhet si më poshtë:

e-mail: matura-a1@akp.gov.al

Nr. Tel: 04/2253864, 04/2259654

Cel: \_0684053163

Më poshtë po ju përcjellim kalendarin e aplikimit online të formularit A1&A1Z si dhe instruksionet e përgjithshme për aplikim:

#### ***Aplikimi online i Formularëve A1& A1Z***

|   | Data e fillimit      | Data e përfundimit        |
|---|----------------------|---------------------------|
| <b>Formulari A1</b>   | <b>10 mars 2015</b>  | <b>24 mars 2014</b>       |
| <b>Formulari A1/Z</b>   | <b>25 mars 2015</b>  | <b>31 mars 2015</b>       |
| <b>Afishimi i aplikimeve të Formularëve A1 dhe A1Z në shkollë</b> |                      | <b>deri 16 prill 2015</b> |
| <b>Korrigjimet e gabimeve në formularët A1 dhe A1Z</b>            | <b>16 prill 2015</b> | <b>30 prill 2015</b>      |

Përdoruesit e sistemit online, për plotësimin e formularit A1&A1Z nëpër shkolla do të jenë:

1. Drejtori dhe nëndrejtorët e shkollës
2. Mbikëqyrësit e maturantëve aplikues (caktohen nga drejtori i shkollës)
3. Mësuesit kujdestarë
4. Maturantët/ kandidatët aplikues

Mbikëqyrësve të shkollave do t'u shpërndahen me përgjegjësi maksimale nga Drejtori i shkollës [Username](#) dhe [Passwordet](#) e sistemit Matura Online si dhe Deklaratën e konfidencialitetit (për ruajtjen e të dhënave personale të maturantëve dhe kandidatëve pjesëmarrës në procesin e Maturës Shtetërore 2014). Kjo e fundit firmoset nga mbikëqyrësi dhe vuloset nga Drejtori i shkollës dhe më pas përcillen zyrtarisht pra

DAR/ZA-së respektive. Një kopje të deklaratave të firmosura për çdo mbikëqyrës, sëbashku me listën e mbikëqyrësve të shkollave të varësisë DAR/ZA i dërgon zyrtarisht pranë AKP-së brenda datës 10.03.2015.

Detyrimisht mësuesit e informatikës dhe Specialistët e IT të Dar/Za-ve duhet të jenë monitorues në laboratorët ku do të bëhet aplikimi, për të vëzhguar gjendjen teknike të pajisjeve hardware si dhe për konsultimin e mësuesve kujdestarë dhe nxënësve për plotësimin e formularit A1&A1Z online.

Aplikimi online i formularit A1&A1Z do të bëhet në shkollat e përqendruara të qyteteve dhe qytezave të DAR/ZA-ve, të cilat jua keni dërguar zyrtarisht më parë Agjencisë Kombëtare të Provimeve (AKP).

Kujtojmë se laboratorët e përzgjedhur duhet t'i kenë kompjuterët në gjendje pune dhe të lidhura të gjithë në internet, pra Switch-et të jetë në gjendje pune.

Një kërkesë e rëndësishme të cilën po jua theksojmë është që laboratorët të kenë nga një printer në gjendje pune, të konfiguruar si printer rrjeti, si dhe të furnizuar me toner (bojë printeri) dhe letër në sasi të mjaftueshme për shtypjen e formularëve A1&A1Z të gjithë maturantëve që aplikojnë në atë laborator.

Vëmë në dukje që formularët A1&A1Z, pas aplikimit online nga maturanti si dhe plotësimit të tij me të dhënat përkatëse nga mësuesi kujdestar dhe mbikëqyrësi, do të printohen në dy kopje dhe do të firmosen nga maturanti, mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës si dhe të vulosen me vulën e shkollës. Njëra prej këtyre kopjeve e sigluar dhe vulosur nga DAR/ZA do të rruhet në DAR/ZA për një vit.

Ju kujtojmë se deri më datën 10 mars 2015 duhet të na dërgoni me e-mail në adresat [matura-a1@akp.gov.al](mailto:matura-a1@akp.gov.al) listën e mbikëqyrësve sipas shkollave që kanë marrë username dhe passwordet ku do të bëhet aplikimi online të plotësuar sipas modelit bashkëngjitur në format excel.

*Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe duke ju uruar suksese gjatë gjithë procesit të Maturës Shtetërore*

**Agjencia Kombëtare e Provimeve**